

#3233
Barinj dhe mësues
Efesianëve 4:12–13

Ju ftoj ta hapim Biblën së bashku te kapitulli 4 i Efesianëve. Jemi duke studiuar Letrën e Efesianëve. Tani kemi arritur në vargun 11, prandaj do të lexojmë nga vargu 11 deri në fund të kapitullit—jo, deri në fund të vargut 16. Efesianëve 4:11-16:

Dhe ai dha disa si apostuj, të tjerë si profetë, të tjerë si ungjilltarë, të tjerë si barinj e mësues, për ndreqjen e shenjtoreve, për veprën e shërbimit dhe për ndërtimin e trupit të Krishtit, derisa të arrijmë të gjithë tek uniteti i besimit dhe i njohjes së Birit të Perëndisë, te një burrë i përsosur, në masën e moshës së plotësisë së Krishtit, që të mos jemi më foshnja, të hedhur andej-këndeje dhe të çuar aty-këtu nga çdo erë e doktrinës, nëpërmjet mashtrimit të njerëzve dhe dinakërisë së tyre që me dredhi çojnë në gabim, por, duke thënë të vërtetën me dashuri, të rritemi në çdo gjë drejt atij që është kreu, Krishti. Prej të cilit gjithë trupi i bashkuar dhe i lidhur mirë, me anë të bashkimit të ndihmesës sipas masës së veprueshmërisë së çdo pjese të veçantë, shkakton rritjen e trupit, për ndërtimin e vetes së tij në dashuri.

Lavdi Perëndisë për Fjalën e tij!

Ndërsa kthehemi te Bibla, shkojmë para Perëndisë në lutje:

At qiellor, ne përkulemi në praninë tënde. Qoftë Fjala jote standardi ynë, qoftë Fryma jote mësuesi ynë dhe lavdia jote qoftë interesi ynë më i lartë! Përmes Jezu Krishtit Zotit tonë. Amen.

Herën e fundit folëm për elementet themelore që Pali na jep në këtë pjesë, duke përshkruar dhuratat e Krishtit të lartësuar: “Dhe ai dha disa si apostuj, të tjerë si profetë” dhe “të tjerë si barinj e mësues”, ose siç përkthehet më zakonshëm, pastorë dhe mësues, dhe siç kuptohet në mënyrën më të zakonshme, një ofiq i dyfishtë—si përkujdesje, ashtu edhe mësimdhënie. Të paktën unë kështu e kuptoj. Megjithatë, çfarë duhet të bëjmë ne me rolin e bariut-mësues? Është jashtëzakonisht e rëndësishme që, si ata që e luajnë këtë rol, ashtu dhe ata që përfitojnë nga ushtrimi i kësaj dhuntie në bashkësi, ta kuptojnë këtë.

Më lejoni t’ju jap një citim, i cili që me fjalinë e parë, mund të na kapë disi të papërgatitur: Bariu-mësues “mban ofiqin më të lartë të përgjegjësisë njerëzore në të gjithë krijimin.” Tani, dua t’ju jap një listë rolesh të mundshme që mund t’i përmbushni në shoqëri. Ne kemi rolin e kryeministrit, atë të kongresmenit, kemi profesionistë golfi, kemi kirurgë kardiologë, kemi shumë role të ndryshme, kemi dhe një rol bari-mësues. Do t’i vendosim ato sipas radhës nga një deri në gjashtë. Ku mendoni se do të vendosen secili prej tyre?” Nuk mendoj se do të jetë e mundur; nuk mendoj që roli i bariut-mësues do të përfshihej në gjashtë rolet më të rëndësishme. Mendoj se personi i zakonshëm do të thoshte: “Për çfarë shërben kjo? Pse ta përfshijmë këtë?”. Personi që tha kështu, vazhdoi të thoshte: “Ai është thirrur të predikojë Fjalën, t’i mësojë të vërtetën popullit të Perëndisë, ta udhëheqë popullin e Perëndisë në adhurim, të kujdeset për tufën si një bari i dhembshur, dhe ta mobilizojë kishën për dëshmi dhe shërbim të krishterë.”¹

Kjo është një thirrje mjaft e lartë, apo jo? Kur dikush e lexon këtë, menjëherë thotë: “Askush nuk është i zoti nga vetja për një përgjegjësi të tillë”, duke i bërë kështu të vetëdijshëm si personin që është thirrur në këtë rol, ashtu dhe ata që përpiqen ta mbështesin atë, në lidhje me varësinë absolute në hirin e Perëndisë për ta përmbushur detyrën e caktuar. Konferenca jonë e

¹ R. Albert Mohler Jr., parathënia e librit *On Being a Pastor*, nga Derek J. Prime and Alistair Begg-u, rishikuar dhe redaktuar (Chicago: Moody, 2004), 9.

fundit për pastorët, e cila mendoj se ishte konferenca e tetëmbëdhjetë radhazi, është ndërtuar mbi idenë themelore që ne besojmë në shërbesën pastorale—ne besojmë që, në fakt, roli i bariut-mësues është roli më jetik.

Lloyd-Jones-i thoshte: “Nuk e konsideroj ulje në detyrë braktisjen e fronit si mbret për të qenë predikues. Roli i predikuesit është edhe më i lartë.” Ju sigurisht që e mbani mend se vetë Lloyd-Jones-i ishte doktor; ai ishte ndihmësi i Lordit Horder, i cili ishte doktori i familjes mbretërore të Britanisë së Madhe. Ai e la atë pozitë, që të fillonte të jepte mësim Biblën në një kishë të vogël kalviniste-metodiste në Wales. Të gjithë thanë: “Ky duhet të jetë i çmendur. Kush do ta braktiste një pozitë të tillë kaq të lartë për të dhënë mësim Biblën—ai nuk ishte thjesht doktor, por ishte doktor në një pozitë kaq të lartë dhe me rëndësi? Çfarë mendon ai vallë?”. E kuptoni, ne duhet të mendojmë thellë për gjërat, apo jo?

Nga vjen ky rol i bariut-mësues? Kush e shpiku? Përgjigjja është kjo: Perëndia e bëri. Jezusi e bëri. Ai është caktuar si dhuratë për kishën, si dhuratë nga Krishti i lartësuar. Ai duhet ta pajisë kishën përmes ushqyerjes frymërore. Prandaj, shërbesa e Fjalës së Perëndisë është një dhuratë të cilën populli i Perëndisë e shpërfill në dëm të vetes.

Gjërat thelbësore të rolit të bariut-mësues

Ka disa gjëra thelbësore të cilat janë në themel të gjithçkaje që kemi bërë gjatë viteve në kishën “Parkside”, dhe meqë ne i shpallim ato rrallë, mendova që të mos ju rikujtoj çdo bindje thelbësore në lidhje me këtë çështje, por ndoshta vetëm tri prej tyre.

Së pari, të vëmë re që bariu-mësues është një nga pleqtë në kishë—që ne e kuptojmë modelin e udhëheqjes së Dhiatës së Re si parësi dhe pluralitet. Ja pse, kur Pali i shkruan Timoteut, ai i thotë: “Pleqtë që qeverisin mirë, le të nderohen dyfish, sidomos ata që mundohen në fjalë e

mësim.”² Pra, me fjalë të tjera, ka një dallim mes disave që e udhëheqin kishën, dhe duke e bërë këtë, jo të gjithë janë të përfshirë në shërbesën publike të predikimit, e cila vjen me këtë rol.

Së dyti, brenda asaj udhëheqjeje të përbashkët, sikurse brenda çdo ekipi udhëheqjeje, duhet të ketë një udhëheqës mes udhëheqësve. Zgjedhja më me vend është që udhëheqësi të jetë ai që ka rolin parësor të mësimdhënies, në mënyrë që timoni që e drejton kishën “Parkside”, të jetë në thelb timoni i Shkrimit, dhe për pasojë, në mënyrë të pashmangshme, përgjegjësia për ushtrimin e atij roli udhëheqës bie mbi atë që ka epërsinë e mësimdhënies së Shkrimit.

Tani që e kemi thënë këtë, fokusi ynë në vazhdim do të jetë në qëllimin për të cilin Zoti ia dha kishës dhuntinë e bariut-mësues. Le të tregohemi të qartë: Kush e dha këtë dhuratë? Cili është burimi i saj? Krishti i lartësuar. Çfarë janë këto dhurata që ai i përmend? Ato janë të gjitha dhunti të Fjalës. Janë të gjitha dhunti të Fjalës. Kur apostujt shpallën Fjalën, thanë: “Këto janë gjëra që ne kemi parë, që kemi dëgjuar dhe që kemi prekur.”³ “Nuk erdhëm te ju”, thanë ata, “duke ju treguar përralla.”⁴ Në fakt, ne e kemi thënë shpesh, nuk do të kishim Dhiatë të Re pa ringjalljen e Jezu Krishtit. Nëse Jezusi nuk do të ishte ringjallur prej së vdekurish, nuk do të kishte asnjë mundësi që këto gjëra që kemi, të ishin shkruar ndonjëherë. Jo. Apostujt ishin në Fjalë, profetët ishin në Fjalë, ungjilltarët po e përhapnin Fjalën kudo që të ishte e mundur, dhe ndërsa kishat filluan të themeloheshin, Perëndia tha: “Tani, dua që të siguroheni që roli i bariut dhe mësuesit të themelohet mirë.” Arsyeja për këtë është deklaruar në vargun 12: “për ndreqjen e shenjtoreve, për veprën e shërbimit”, që trupi i Krishtit të ndërtohet.

Kjo është pak ndryshim teme, por mendoj se thekson diçka të rëndësishme. Në versionin e autorizuar—përkthimin e Mbretit James, me të cilin u rrita, në atë version ka dhe një presje. Ju

² 1 e Timoteut 5:17.

³ 1 e Gjonit 1:1–3 (parafrazim).

⁴ 2 e Pjetrit 1:16 (parafrazim).

thoni: “Vërtet? Për atë do që të flasësh?”. Po, për atë dua të flas vetëm për pak çaste. Dua t’ju them se ku vjen presja. Vargu 12 në versionin e autorizuar thotë: “për ndreqjen e shenjtorëve, për veprën e shërbimit dhe për ndërtimin e trupit të Krishtit.” Nuk ka ndonjë autoritet gjuhësor në lidhje me punën e presjeve—për *çdo* presje, kudo që të jetë. Në tekstin origjinal nuk kemi presje, dakord? Kjo, pra, është një përpjekje nga ana e përkthyesve për ta kuptuar tekstin. Në urtësinë e tyre, ata vendosën atje një presje.

Mirëpo, kur e lexoni me një presje në atë vend, kuptimi i tekstit ndryshon krejtësisht. Sepse çfarë bën presja? E vendos të gjithën këtë në duart dhe në përgjegjësinë e bariut-mësues, sepse shiko se si lexohet: atyre u dhanë barinj dhe mësues për ndreqjen e shenjtorëve, “për ndreqjen e shenjtorëve, për veprën e shërbimit, për ndërtimin e trupit të Krishtit.” Me fjalë të tjera, e gjithë kjo bëhet përgjegjësia e vetme e atij shpirti të mjerë, të cilit i është besuar puna e bariut dhe mësuesit. Kjo është mënyra se si shumë bashkësi vazhdojnë të funksionojnë ende: “Hej, ne e morëm në punë, dhe këtë do të bëjë: ai do t’i përsosë dhe do t’i pajisë shenjtorët. Ai do ta bëjë punën e shërbesës. Ai do t’i hedhë plehërat. Ai do të bëjë atë që ne duam të bëjë! Dhe nëse ai nuk e bën, atëherë do të marrim dikë që *do ta* bëjë.” E po, ajo presje duhet hequr, jo vetëm për të mirën e bariut-mësues, por edhe për të mirën e bashkësisë, sepse gjithë zhvillimi i efektshëm i një bashkësie të ndërtuar kërkon që aty të mos ketë presje. Pastaj, vargu lexohet “për ndreqjen e shenjtorëve për veprën e shërbimit...” “Që trupi i Krishtit të mund të ndërtohet” (versioni NIV).

Krishti i lartësuar i jep një dhuratë kishës: rolin e bariut dhe mësuesit. Prandaj, ata barinj dhe mësues duhet ta pajisin popullin e Perëndisë për veprat e shërbimit, gjë të cilën ata e bëjnë që trupi i Krishtit të mund të arrijë realisht pjekurinë. Prandaj, ju e kuptoni që kur e anashkaloni këtë, përfundoni me një bashkësi e cila ka ngecur në njëfarë kuptimi.

Ka tri fjalë të cilat dua që t'i kuptojmë këtë mëngjes. Ato janë mjaft të thjeshta dhe dalin nga teksti. Në shënimet e mia kam shkruar inicialet "SHUM"—SHUM. *Shërbim, unitet dhe maturi. Shërbim, unitet dhe maturi.* Dakord?

Shërbim

"Për ndreqjen e shenjtorëve, për veprën e shërbimit." Fjala e përdorur këtu është *diakonia*. Është e njëjta fjalë e cila është rrënja e fjalëve *dhjak* ose *dhjake*. Në kishën "Parkside", njerëzit na thonë: "Nuk keni dhjakë." E po, kjo, në fakt, nuk është e vërtetë. Ne kemi *qindra* dhjakë. Ne kemi qindra njerëz të cilët po shërbejnë në përgjegjësi diakonie. Kjo kishë, në fakt, do të pushonte së ekzistuari nëse nuk do të ishte kështu. Megjithatë, ajo që njerëzit mendojnë zakonisht, është që ka një dhomë të vogël e cila ka tabelën "Dhoma e dhjakëve", ku shkojnë të gjithë dhjakët dhe bëjnë atë që bëjnë. Mirëpo, në fakt, është e mundur të kesh një funksion prej dhjaku pa pasur një dhomë dhe një tabelë. Kjo do të thotë thjesht që të bësh veprat e shërbimit. Kjo është e njëjta fjalë të cilën e gjeni në tregimin e Martës dhe Marisë. Mbani mend: "Marta ishte e shpërqendruar, duke shërbyer fort."⁵ "Duke shërbyer fort." Pra, përgjegjësia e bariut-mësues është që t'i pajisë shenjtorët duke e dhënë mësim Biblën në mënyrë të tillë që, mekanizmat dhe veglat për shërbesë të vendosen në duart e tyre, dhe kështu ata ta bëjnë këtë punë me efektshmëri.

Në shkurt të vitit 1941, Winston Churchill-i dha një prej fjalimeve të tij më të paharrueshme në Londër. Ai e dinte që ky fjalim do të dëgjohej në Shtetet e Bashkuara, dhe e dinte me saktësi se çfarë po bënte. Me një pyetje retorike, ai tha në mes të fjalimit: "Nëse do të më pyesnit mua se çfarë do t'i thosha zotit Roosevelt, do t'i thosha këtë: 'Na jepni mjetet dhe ne do ta mbarojmë

⁵ Luka 10:40.

punën.”⁶ “Na jepni mjetet dhe ne do ta mbarojmë punën.” Sigurisht që Roosevelt-i dhe Shtetet e Bashkuara bënë pikërisht këtë gjë. Ata i pajisën forcat aleate për ta hequr qafe regjimin e Hitlerit. Mjetet ishin absolutisht të nevojshme. Ato janë absolutisht të nevojshme nëse duam që populli i Perëndisë të bëjë këtë lloj shërbese.

Në fakt, fjala “ndreq” është një term mjekësor nga fusha e ortopedisë. Kjo fjalë përdorej për ndreqjen e një gjymtyre të thyer. Kjo është gjithashtu një fjalë të cilën e gjejmë tek Ungjijtë, kur thuhet që dishepujt po ndreqnin rrjetat e tyre; e njëta fjalë përdoret edhe në atë rast; ata po e pajisnin veten e tyre për lundrimin e radhës. Prandaj, ajo që ndodh, është që shërbesa e Fjalës së Perëndisë i ndikon jetët e popullit të Perëndisë me anë të fuqisë së Frymës së Perëndisë, që—nëse ju pëlqen, të qëndrojmë me tablonë e rrjetave të peshkimit—që tiparet e ngatërruara, me nyje apo të shkëputura të jetëve tona të mund të sillen në përputhje me planet dhe qëllimet e Perëndisë, që kur të vazhdojmë shtegtimin e jetës, të jemi pajisur të bëjmë atë për të cilën jemi aftësuar.

Kjo, pra, e ndryshon në mënyrë radikale idenë e dëgjimit dhe të mësimin të Fjalës së Perëndisë. Kjo e heq atë menjëherë nga ideja që thotë: “A ishte mirë? A ishte gjatë? A ishte shkurt? A më pëlqeu? A më preku? A më trazoi? A isha i lumtur? A u ndjeva mirë?”. Papritur, të gjitha këto nuk është se nuk kanë rëndësi, por këto i shërbejnë pyetjes: “A u ushqeva? A u pajisa? Kur shkoj në këtë vend, a ndihem se po përgatitem për udhëtimin e jetës? A po më ndihmon me martesën time, me familjen time, me biznesin tim? A po shfaqen praktikatat e jetës së krishterë ndërsa Fjala e Perëndisë shpallet?”. Kjo po përshkruhet këtu. Ja pse mënyra se si e dëgjojmë Biblën është kaq e rëndësishme.

Ju kam thënë edhe më parë, ishte një burrë që predikonte në konferencën e Keswick-ut në Lake District të Anglisë, emri i të cilit ishte S. D. Gordon. Ai kishte një zë shumë të qetë dhe

⁶ Winston Churchill, “Give Us the Tools” (fjalim radiofonik, Londër, 9 shkurt 1941). Parafrazim.

thoshte: “A po dëgjoni? A po dëgjoni me gjithë veshët e zemrës suaj?”. Kjo është një pyetje e mirë! Sepse, mbani mend, Jakobi thotë: “Nëse keni një mendje të ndyrë, nëse keni një zemër të zemëruar, pse ta dëgjoni Biblën? Ju keni nevojë të siguroheni që kur ta pranoni Fjalën”, thotë ai, “ta pranoni me butësi fjalën e mbjellë brenda jush, e cila është në gjendje ta shpëtojë shpirtin tuaj.”⁷ Prandaj, vendi i Fjalës së Perëndisë në sjelljen e dikujt te besimi në Perëndinë është absolutisht i domosdoshëm.

E di që ka njerëz të cilët kanë pyetje gjithë kohën për këto gjëra, dhe me të drejtë, i kuptoj. Kur Pali u shkruan thesalonikasve, duke i lavdëruar te 1 e Thesalonikasve 2, u thotë atyre: “Prandaj edhe ne e falënderojmë pa pushim Perëndinë, se kur e morët fjalën e Perëndisë, që dëgjuat nga ne, e pritët jo si fjalë njerëzish, por, sikurse është me të vërtetë, si fjalë Perëndie, që edhe vepron në ju që besoni.”⁸ Njerëzit na pyesin gjithë kohën: “Pse ka kaq shumë rëndësi Fjala e Perëndisë? Pse na duhet Fjala e Perëndisë? Pse të mos dalësh dhe të bësh diçka në komunitet? Pse t’i japim këtë theks?”. Ju e kuptoni që këtë bëjnë të krishterët: ata e pranojnë autoritetin e Fjalës së Perëndisë. Kjo është pjesë e të qenët i krishterë.

Dikush mund të thotë: “E po, çfarë mund të themi për problemet që vijnë bashkë me këtë?”. E po, gjithçka vjen me problemet e saj. Si i krishterë e pranon që Perëndia është dashuri, apo jo? Kjo ngre menjëherë një problem. Problemi është ky: “Çfarë i ndodhi fëmijës tim kur vdiq si foshnjë?”. Kjo gjë ngre menjëherë pyetjen e problemeve të vuajtjes përreth botës. Çfarë bëni? Ju bëni atë që bëni. Ju nuk e braktisni dashurinë e Perëndisë, për shkak se përballeni me probleme: ju i hetoni problemet nën dritën e dashurisë së Perëndisë. Çfarë bëni në lidhje me Biblën kur hasni

⁷ Jakobi 1:19–21 (parafrazim).

⁸ 1 e Thesalonikasve 2:13.

probleme? Ju nuk e braktisni atë për shkak të problemeve; ju e besoni Biblën dhe përlesheni me problemet.

Jezusi u tha dishepujve të tij: “Ju më quani Mësues dhe Zot, dhe mirë bëni, sepse jam.” Duke qenë se ai është ai që është, ne nuk e kemi lirinë që të mos biem dakord me atë që thotë ai, madje as nuk kemi ndonjë liri për të mos iu bindur asaj që ai thotë. E kuptoni që, në fund të fundit, gjërat vijnë te kjo çështje themelore: A është Jezu Krishti ai person që pretendoi të ishte? Pastaj, nëse ai në lavdinë e tij të lartësuar ia ka dhënë këtë dhuratë kishës, ne duhet të sigurohemi që po i kushtojmë vëmendje asaj.

Ajo që dua ta kuptoj po aq mirë është kjo—kësaj mendoj se i jemi referuar më parë. Ju do ta vini re që lidhja e drejtpërdrejtë nuk është mes “ne japim mësim Biblën” dhe “kisha maturohet”. Jo. Bibla jepet mësim, shenjtorët maturohen, ata bëjnë veprat e shërbimit dhe kisha ndërtohet. Pra, e thënë ndryshe, ekziston një lidhje, apo jo? Nëse nuk arrijmë ta kuptojmë mënyrën në të cilën, jo vetëm që e pranojmë Biblën kur na jepet mësim, por edhe në mënyrën sesi e marrim me vete, dhe themi: “Ka rrjedhoja për këtë, prandaj, nëse mund ta themi kështu, rritja frymërore dhe numerike e kishës nën bekimin e Perëndisë lidhet drejtpërdrejt me të gjithë ata që janë anëtarë të kishës, të cilët bëjnë atë që duhet të bëjnë—si për shembull, t’i fikin celularët. Kësaj do t’i kthehem më vonë. E vini re frazën në fund të vargut 16: “sipas masës së veprueshmërisë së çdo pjese të veçantë.” “Sipas masës së veprueshmërisë së çdo pjese të veçantë.” E keni parasysh atë zhurmën e tmerrshme që bën skaneri në spital, e po, bën mirë që të funksionojë si duhet. (Në fakt, nuk është skaneri. Është rezonanca magnetike ajo që e bën atë zhurmë.)

Kjo ndryshon gjithçka. Kur isha në shkollë në Skoci, kishim zakon të këndonim këtë këngë:

Ka një punë për Jezusin, që ti duhet ta bësh,
Është një detyrë që Mjeshtri për ty e planifikoi.
Nxito të bësh atë që thotë ai, shërbeji me të vërtetë;

Ka një punë për Jezusin, që vetëm ti mund ta bësh.⁹

A e besoni me të vërtetë këtë? A e besoni që Perëndia ju ka dhënë një vend, një qëllim dhe një funksion? Mos shihni përreth e të thoni: “Unë nuk jam i tillë, nuk jam ai, nuk jam ajo.” Këtë harrojeni! Mëso të thuash bashkë me peshkopin e vjetër anglikan: “Jam vetëm një njeri, ama jam një. Nuk mund të bëj dot gjithçka, ama mund të bëj diçka. Atë që mund ta bëj, duhet ta bëj. Atë që duhet ta bëj, do ta bëj me ndihmën e Perëndisë.”¹⁰ Kjo, shumë të dashur, është shërbesa. Shërbesa. Si rezultat i kësaj, kisha ndërtohet.

E thënë ndryshe, ky është një mekanizëm për ndërtimin e trupit. Në fakt, *unë* nuk duhet të flas fare për formimin e trupit—dhe për këtë dua të dëgjoj një amen të fortë diku. Jo, e kuptoj! Ama, kam parë ata që merren me zhvillimin e muskulaturës! Disa prej jush merren me këtë. Shpesh përplasem me ju dhe them: “Oh, *kështu* duhet të jetë!”. Mirëpo, burri normal që merret me zhvillimin e muskulaturës, të paktën ata që kam parë unë, nuk është dhe aq i zhdërvjellët. Dua të them që ata hungërijnë dhe i lënë të gjithë gojëhapur. Ama, e dini çfarë? Unë i sfidoj në një garë njëqind metërshi, kur të duan ata—shumicën prej tyre. Jo disa nga sportistët profesionistë, sepse nuk dua të hyj në telashe. Ama është fakt që, kur mendojmë për këtë gjë në terma biblikë, nuk po flasim thjesht për madhësinë. Jemi duke folur për zhdërvjelltesinë. Po flasim për shkathtësinë. Po flasim për aftësinë për t’u ulur dhe për t’i marrë gjërat.

Ne duhet të sigurohemi që metafora të cilën e kemi në mendje për trupin që funksionon në këtë mënyrë, nuk është ajo e një autobuzi, ku të gjithë ulen dhe kritikojnë shoferin, ku të gjithë jemi një grup konsumatorësh, por nuk jemi kontribues. Gjithsesi, nuk duhet të kemi në mendje as tablonë e një hinke në të cilën keni një bari-mësues i cili nuk i delegon asgjë asnjëri, dhe gjithçka

⁹ Elsie D. Yale, “There’s a Work for Jesus” (1912).

¹⁰ Zakonisht i atribuohet Edward Everett Hale-s. Parafrazim.

duhet të kalojë përmes tij. Ka shumë kisha të vogla ku, në fakt, problemi qëndron te bariu-mësues; por ai nuk ballafaqohet me problemin. Kjo ndodh ngaqë ai mendon se *duhet* të bëjë gjithçka, përndryshe, në njëfarë mënyre, besueshmëria e tij do të vihet në rrezik, prandaj, ai nuk tërheq kurrë rreth vetes njerëz që janë më të mirë se ai. Ka të ngjarë që ai të jetë i cenueshëm nga kjo; ai nuk do që ndokush ta dijë se nuk është i zoti në gjithçka. Mirëpo, me kalimin e kohës, të gjithë e dinë se nuk jeni të zotë në gjithçka. Me kalimin e kohës, ata nisin të vrasin mendjen nëse jeni të zotë në *ndonjë gjë*.

Autobuzi. Hinka. Orkestra. Luaj pjesën tënde. Dëshiron të jesh një muzikant që i bie bilbilit? Bjeri bilbilit për lavdinë e Perëndisë! “Por mua më pëlqen t’i bie një violonçeli të madh.” Oh, vërtet? Po më thua që kur orkestra të marshojë, ti dëshiron t’i biesh një violonçeli të madh? Mos po më thua se nuk je i lumtur që ta mbash bilbilin e vogël në xhepin e brendshëm të xhaketës? Perëndia e di se çfarë po bën!

E po, bëjmë mirë që të vazhdojmë.

Uniteti

Shërbim dhe *unitet*. Unitet. Pali e ka filluar kapitullin duke i inkurajuar ata, jo që ta *krijojnë* unitetin; sepse tashmë ata e kanë atë në dhe përmes Krishtit. Në bashkimin e tyre me Krishtin, ata janë bashkuar me njëri-tjetrin, prandaj, ky është një unitet që duhet ruajtur—vargu 3—dhe pastaj kalojmë te vargu 13, ku bëhet fjalë për unitetin që e arrijmë. Prandaj, uniteti është diçka që duhet ruajtur dhe diçka që duhet arritur. Ai tashmë ju ka thënë që “ju jeni banesë për Perëndinë me anë të Frymës së Shenjtë”.¹¹ Unikaliteti i kishës është themelor për ndikimin e saj.

¹¹ Efesianëve 2:22 (parafrazim).

Nëse lexoni historinë e kishës, do të mësoni që kisha është gjithmonë në pozitën e saj më të efektshme, kur ajo është më fort kundërkulturore. Çdo herë që kisha pushtohet nga kultura ose kur identifikohet nga ana politike ose shoqërore me një sistem të caktuar, bëhet më pak e dobishme. Për shembull, në 250-300 vitet e saj të para, kisha u përndoq. Ata u ndoqën këmba-këmbës. Pastaj, Kostandini u bë i krishterë. Papritur, kisha u institucionalizua. Tani perandori romak ishte pjesë e kësaj gjëje. Një nga pyetjet e mëdha me të cilat janë përballur historianët e kishës në atë kontekst dhe më gjerë është kjo: “A e bëri kjo kishën më të efektshme apo më pak të efektshme?” Historia mbështet argumentin që kjo ngjarje e bëri kishën më pak të efektshme. Arsyeja ishte se kishte pështjellim në lidhje me faktin nëse kjo ishte një çështje politike apo një realitet frymëror.

Shumë të dashur, edhe sot kemi të njëjtin pështjellim! Kisha është në pozitën e saj më të mirë kur njerëzit thonë: “Kjo nuk është ajo që prisja.” Mund të them më shumë në lidhje me këtë gjë, ose jo—por, në këto 25-40 vitet e fundit, lëvizja progresive brenda ungjillorizmit ka qenë përpjekja për t’ua bërë të ditur të gjithëve që nuk jemi njerëz të çuditshëm. “Ne jemi njëlloj si ju! Ne vishemi si ju, ne ecim si ju, ne flasim... në çfarëdo fushe tjetër, ne jemi si ju.” Dhe njerëzit thonë: “E po, nëse jeni njëlloj si ne, përse na duheni *ju*?”. “Po, jo, ne kemi të njëjtën muzikë. Po, ne kemi të njëjtin stil jete. Po, ne kemi gjithçka njëlloj. Prandaj e bëmë kështu: që ju të na pëlqeni ne.”

Çfarë ka ndodhur tani pas dyzet vjetësh? Brezi i mijëvjeçarit thotë: “Ju nuk na pëlqeni. Ne as që duam të kemi të bëjmë me ju. Vërtet mendoni se meqë e konsideroni veten tipa interesante, kjo do të na bëjë të duam të vijmë dhe të dëgjojmë? Apo fakti që, edhe pse jeni në të gjashtëdhjetat, vazhdoni të vishni xhinse? Prisni që ne të themi: ‘Oh, ai vesh xhinse, atje duhet të shkojmë!’”. Jo, ata janë më të zgjuar se kaq. Më lejoni t’ju them se çfarë po kërkojnë ata: po kërkojnë diçka që është radikalisht e ndryshme. Ja pse shumë prej tyre magjepsen nga ortodoksia lindore. Ja pse kaq

shumë prej tyre janë hedhur në kërkim të frymërores, në kërkim të një dimensionit thelbësor, i cili nuk sigurohet nga cikërrimat që paraqiten në kaq përpjekje të kishës, për të vërtetuar se ne mund t'ju bëjmë pjesë tonën, duke qenë njëlloj si ju. Jo! Kisha duhet të jetë shumë, shumë e ndryshme, sepse uniteti që ekziston është uniteti në besim dhe në njohjen e Zotit Jezu Krisht.

Kisha nuk është si çdo organizatë tjetër. Ka lloj-lloj klubesh, pjesë e të cilave bëheni përmes arritjeve ose statusit tuaj shoqëror. Por kisha nuk është si një nga këto. Hyrja në kishë është me anë të hirit të Perëndisë. Prandaj, lexuesit në kishat efesiane e kuptuan që “vetëm Perëndia mund t'i bëjë bashkë ata judenj dhe ata paganë. Ata e urrejnë me shpirt njëri-tjetrin! Një ditë, shkova në një nga bashkësitë e tyre dhe ata ishin ulur krah për krah. *Diçka* ka ndodhur atje. Një gjë të tillë nuk e kemi parë kurrë.” Anëtarët e bashkësive efesiane e kuptuan që i vetmi person i cili do të përjashtohet nga kisha, do të ishte ai apo ajo që mendon se nuk ka nevojë për hir.

Jo. Ju e dalloni që hyrja për në kishë—siç tha Rutherford-i, një teolog i lashtë skocez—hyrja në njohurinë e Jezusit është e ulët, e ulët. Në fakt, çfarë tha Rutherford-i? “Uleni velën!” “Uleni velën! Përkuluni, përkuluni!” Udhë e Krishtit “është një hyrje e ulët.”¹² “Nuk dua të gjunjëzohem ashtu. Dua të hyj *kokëllartë*.” Jo. Nuk mundesh. Nuk mund të hysh ashtu kur hiri i Perëndisë të tregon se kush je dhe çfarë je, kur të tregon mrekullinë se kush dhe çfarë është Jezusi. Atëherë të gjitha gjërat që na dallojnë si të rëndësishëm, në fakt, nuk kanë rëndësi; ato thjesht i nënshtrohen unitetit që vjen në njohjen e Zotit Jezu Krisht.

A e *njuh* Zotin Jezu Krisht? Ti thua: “E po, jo, ndoshta e njoh, ndoshta nuk e njoh. Jo, nuk mendoj se e njoh. Nuk e kam takuar kurrë.” E po, nuk ke për ta takuar kurrë. Dua të them që ai nuk ka dalë shëtitje nëpër qytetin e Cleveland-it. Ti thua: “E po, nëse do të jetoja në një epokë tjetër, ndoshta do të besoja, por jo tani. Ku mund ta njoh Jezusin?”. E po, tani jemi kthyer tek e

¹² Samuel Rutherford, *The Loveliness of Christ: From the Letters of Samuel Rutherford, 1600–1661*, redaktuar nga Ellen S. Lister-i (London: Samuel Bagster and Sons, 1794), 74.

njëjta pozitë. Vetëm përmes Fjalës së Perëndisë, me anë të fuqizimit të Frymës së Perëndisë, mund të arrijmë në njohjen e Birit të Perëndisë. Njerëzit thonë: “Kjo është një enigmë. Si mund ta bëj vallë këtë?”.

I mbani mend dishepujt në rrugën për në Emaus të Luka 24? Ata ishin duke ecur, dhe Jezusi i ringjallur u afrohet. Ata nuk e njohën. Ata “ishin të penguar për të mos e njohur atë”.¹³ Kjo është interesante: “të penguar për të mos e njohur atë”, derisa erdhi koha për ta njohur. Kur e njohën ata Jezusin? Luka na thotë: kur ai ua hapi Shkrimet. Kjo është e jashtëzakonshme, apo jo? Pra, fizikisht, ai është përkrah tyre dhe ata nuk e njohin, dhe ai u bën një studim Bible dhe atëherë ata e njohin!

John Stott-i thotë: “Bibla ‘do t’jua japë Krishtin... në një afrimetet aq të ngushtë, saqë ai do të ishte më pak i dukshëm, edhe po të qëndronte para syve tuaj’.”¹⁴ Bibla “do t’jua japë Krishtin... në një afrimetet aq të ngushtë, saqë ai do të ishte më pak i dukshëm, edhe po të qëndronte para syve tuaj.”

Maturia

Fjala e fundit—të cilën kam kohë vetëm sa për t’jua prezantuar, por do t’i kthehem sërish—është fjala *maturi*. E dalloni zhvillimin. Bariu dhe mësuesi i pajisin shenjtorët, të cilët pastaj përfshihen në shërbesë dhe trupi ndërtohet. Ky është një realitet i vazhdueshëm dhe progresiv “derisa të arrijmë... tek uniteti i besimit dhe i njohjes së Birit të Perëndisë”, të cilin, tani e shohim si në pasqyrë, në mënyrë të errët, por atëherë do të shohim faqe për faqe.¹⁵ Nëse mund ta themi kështu, ka shkallë shenjtërie, dhe për pasojë, ka edhe shkallë uniteti; prandaj është e qartë

¹³ Luka 24:16. Të pjerrëtat janë shtuar.

¹⁴ Introduction to Desiderius Erasmus’s Greek New Testament (1516), cituar në John Stott, *The Incomparable Christ* (Downers Grove, IL: InterVarsity, 2001), 15.

¹⁵ Shih 1 e Korintasve 13:12.

që ka edhe shkallë maturie. Qëllimi i kësaj është që ne të mund të arrijmë “te një burrë i përsosur, në masën e moshës së plotësisë së Krishtit”.

E mbani mend që, në fillim të letrës, Pali është lutur për ata, që të mund “të mbushen në gjithë plotësinë e Perëndisë”.¹⁶ Çfarë lutjeje e mahnitshme, që Perëndia të mund të jetë gjithçka dhe në të gjithë! Për këtë gjë këndojmë: “Për mua je gjithçka.”¹⁷ A e kemi me gjithë mend? Çfarë do të thotë kjo? Çfarë do të thotë? Mund të ketë një kuptim kur e këndojmë së bashku, por çfarë kuptimi ka kur je vetëm, kur je në makinë, kur përballësh me tundimin dhe kur dëshiron të ndjekësh shtegun tënd? “Jo, ti je gjithçka për mua. Dua që të bëhem i pjekur. Nuk dua që të endem andej-këndeje, si një i krishterë foshnjë.”

Në një kontekst tjetër, dje po i thosha dikujt, që gjithë javën kisha menduar për një doktor indian, emrin e të cilit nuk dija, por që e kisha takuar kur isha gjashtëmbëdhjetë vjeç, dhe ai më operoi gishtin e madh të këmbës. Këtë informacion nuk ka pse ta dini. Arsyeja e vetme pse po jua tregoj, është sepse pas operacionit, dikush ma përplasi këmbën me një karrocë supermarketi. Për shkak të kësaj, penjtë e qepjes u këputën, prandaj, m’u desh të shkoja përsëri në urgjencë, tek i njëjti doktor që ma kishte bërë operacionin herën e parë. Ndërsa ai u ul dhe nisi ta qepte sërish plagën, me sa duket unë nuk reagoja me shumë nënshtrim. Nuk do ta harroj kurrë, ai erdhi pas meje dhe më tha: “Ti qenke një foshnjë e rritur!”. Unë ia ktheva: “Nuk mundem...” Mendoj se i thashë diçka të tillë: “Ta tregoj unë kush është foshnjë.” “Ma jep atë gjilpërën. Ta tregoj unë si bëhet kjo punë.” Gjithsesi, kam menduar për këtë gjë gjithë javën. Nuk dua që Zoti të vijë tek unë e të më thotë: “Begg, u rrite, por foshnjë mbete! Je fëmijë, kur do të piqesh?”. Si mund të piqem?

¹⁶ Efesianëve 3:19.

¹⁷ Dennis L. Jernigan, “You Are My All in All” (1990).

Me anë të Fjalës së Perëndisë, përmes shërbëtorëve të Perëndisë, drejtuar popullit të Perëndisë, të përfshirë në shërbesën e Perëndisë.

Tani mendojeni këtë, jo vetëm në nivelin individual—kështu do ta mbyllim—le të mendojmë për këtë gjë në nivelin e përbashkët. Le të mos mendojmë si individë; le të mendojmë për këtë gjë si kishë. Çfarë mund të themi për maturinë e kishës “Parkside”?

Pyetja e parë: A është Fjala forca shtytëse që i jep formë jetës së kishës sonë? Kjo është një pyetje retorike. A është Fjala e Perëndisë forca shtytëse që i jep formë kishës sonë? Sepse mundësia për t’u maturuar varet nga kjo gjë; për aq kohë sa Fjala nuk është forca shtytëse, atëherë jemi duke e zvogëluar mundësinë.

Së dyti, a po banon Fjala e Perëndisë në ne me pasurinë e vet, dhe si rezultat, a po e mësojmë dhe inkurajojmë njëri-tjetrin me çdo urtësi?¹⁸ Kjo është nga Kolosianëve 3.

Së treti, a po jetojmë në atë unitet që krijohet në mënyrë të mbinatyrshme, duke na sjellë bashkë si grup, në dallimin e faktit që jemi të rrethuar nga njerëz që në njëfarë mënyre... me të cilët nuk do të donim të shkonim për pushime së bashku. Nuk ka pse të ndihemi keq për këtë. E megjithatë, ne e duam njëri-tjetrin. Me të vërtetë?

A po rritemi në çdo aspekt drejt tij, drejt Krishtit, në masën e moshës së plotësisë së Krishtit?

Pyetje të rëndësishme.

Shkrimtari i Letrës së Hebrenjve foli shumë hapur në letrën e tij, apo jo? Ai u tha njerëzve: “E dini çfarë? Jam i shqetësuar për ju, sepse jeni bërë të ngathët në dëgjim.” “Të ngathët në dëgjim.” Pra, ata janë ende aty, janë ende duke dëgjuar disi, por, në fakt, nuk po nxënë gjë. Pastaj, ai u thotë: “Sepse, ndonëse tashmë duhet të ishit mësues, keni përsëri nevojë që t’ju mësojë dikush

¹⁸ Shih Kolosianëve 3:16.

gjërat elementare të fillimit të thënieve të Perëndisë.”¹⁹ Çfarë akuze që është kjo për një kishë! Pastaj, më vonë, ai u thotë: “Por lidhur me ju, o të dashur, ndonëse flasim kështu, jemi të bindur për gjëra më të mira, të cilat i përkasin shpëtimit.”²⁰

E po, kësaj do t’i kthehemi. Le të lutemi:

Atë, faleminderit që Fjala jote është një llambë që ndriçon në shtegun tonë,²¹ si individë, ashtu edhe si bashkësi. Ne lutemi që të mund të jemi si ata për të cilët flet Jakobi, të cilët e pranojmë Fjalën e Perëndisë me butësi, duke e ditur se ajo është në gjendje ta shpëtojë shpirtin tonë. Për hir të Krishtit. Amen.

¹⁹ Hebrenjve 5:11–12.

²⁰ Hebrenjve 6:9 (parafrazim).

²¹ Shih Psalmi 119:105.